



# Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo



## Agjencia e Kosovës për Akreditim

Agjencia Kosova za Akreditaciju

Kosovo Accreditation Agency

Data: 11.08.2017

Ref.: 677/17

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 52-të, të mbajtur më 28 Korrik 2017, mori:

### V E N D I M

I. Nuk akreditohet programi i studimit të BPrAL Kolegji Pjetër Budi:

- Shkenca Kompjuterike, BSc, 180 ECTS.

II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

### Arsyetimi

BPrAL Kolegji Pjetër Budi ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për akreditim të programit të studimit: Shkenca Kompjuterike, BSc, 180 ECTS, me stafin akademik si në vijim:

Nr.	Programi i studimit	Niveli	ECTS	Bartësit e Programit
1	Shkenca Kompjuterike	BSc	180	Hashim Rexhepi, Isuf Ahmeti, dhe Sami Behrami

AKA ka organizuar vizitën në BPrAL Kolegji Pjetër Budi më 04.06.2017, me qëllim të vlerësimit të programit të studimit të cekur me sipër me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Volker Gehmlich dhe Peeter Normak.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 28 Korrik 2017 ka shqyrtuar aplikacionin e BPrAL Kolegji Pjetër Budi, dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Për sa i përket mos akreditimit të programit të studimit të cekur më sipër, raporti i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, numëron këto vërejtje kryesore të cilat kanë qar në mos dhënien e rekomandimit për akreditim:

Sipas ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, rezultatet e të nxënit për këtë program të studimit në disa raste kanë qenë shumë të përgjithshme dhe kanë përmbajtur formulime të pakuptueshme, arritja e të cilave është e vështirë nga ana e studentëve dhe është e pamundur të maten. Për më tepër, sipas ekspertëve ndërkombëtarë rezultatet e të nxënit për këtë program studimi nuk harmonizohen pjesërisht me kurrikulën e programit. Ekspertët kanë cekur se përshkrimi i përmbajtjes së lëndëve në disa raste ishte gjithashtu i mangët. Rrjedhimisht ekspertët kanë deklaruar se cilësia dhe qëllimet akademike të programit të studimit nuk janë të përshtatshme për gradën akademike.

Për sa i përket stafit akademik, ekspertët kanë deklaruar se asnjëri nga ligjëruesit e lëndëve specifike nuk ka kontratë të punës me kolegjin dhe se kolegji nuk ka punësuar asnjë staf akademik i cili është i kualifikuar në shkencat kompjuterike. Ekspertët kanë mësuar se bartësit e programit kishin kualifikime nga fusha e sigurimeve, historisë dhe gjeografisë dhe se për më tepër puna hulumtuese e tyre në nivelin ndërkombëtarë është e padukshme. Sipas ekspertëve mungesa e kompetencës në shkencat kompjuterike në kolegji është mangësia më e madhe e Kolegjit – personat përgjegjës për programin e studimit nuk ishin në gjendje ti përgjigjeshin edhe pyetjeve më të thjeshta në lidhje me mësimdhënien në inxhinierinë softuerike.


Për sa i përket punës kërkimore, ekspertët kanë mësuar se puna hulumtuese në kolegji në shkencat kompjuterike është jo-ekzistente.

Për sa i përket menaxhimit të cilësisë, ekspertët kanë deklaruar se programi i propozuar në Shkencat Kompjuterike është një dëshmi e cila tregon për një sistem jo funksional të menaxhimit të cilësisë në Kolegji. Sipas ekspertëve, nëse kolegji ka qëllime serioze për të filluar një program të studimit në shkencat kompjuterike atëherë duhet të punësojë ekspertë të fushës së shkencave kompjuterike të cilët do të udhëheqin zhvillimin e aktiviteteve akademike.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesë për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga data e pranimit të këtij vendimi siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL Kolegji Pjetër Budi;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.

  
Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

